



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 21.07.20

Ref.: 975/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 25.06.2020, mori:

V E N D I M

- I. Nuk riakreditohet Kolegji "Iliria" në nivel institucional.
- II. Ndalohej regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Kolegjit Iliria për vitin akademik 2019 – 2020.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Kolegji Iliria ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional për herën e dytë pas vlerësimit negativ të vitit të kaluar. AKA ka organizuar vizitën në Kolegjin Iliria më datë 14.05.2020 me qëllim të rivlerësimit në nivelin institucional, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Dr. Melita Kovacevic, University of Zagreb, Prof. Dr. Magdalena Platis, University of Bucharest dhe Ms. Oana Sarbu, PhD student, University of Bucharest.

Raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Kolegji Iliria përmbush pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se Kolegji Iliria i plotëson substancialisht (2): Stafit, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Burimet dhe infrastruktura; Plotëson pjesërisht (8): Misionin publik dhe objektivat institucionale; Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi; Planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit; Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Menaxhimin të Cilësisë, Mësimdhënia dhe mësimnxënia; Administrimin e studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Bashkëpunimin institucional. Nuk i plotëson (1): Hulumtimi.

Kapitulli i parë (Misioni publik dhe objektivat institucionale / Pjesërisht e përmbushur) Ekspertët kanë konstatuar se misioni dhe vizioni janë të ndërtuar nga tri shtylla: arsimimi, hulumtimi dhe shërbimi ndaj shoqërisë. Hulumtimi është definuar si mënyrë e zhvillimit individual të studentëve që është mjaft e pazakontë si koncept. Përderisa misioni është i formuluar në mënyrë të pranueshme, prapëseprapë ai nuk krijon parakushte për një plan strategjik i cili do të ishte i ndërlidhur me hulumtimin. Në të njëjtën kohë, misioni i institucionit nuk i jep atij veçori të cilat e bëjnë dallimin me institucione të tjera në nivel lokal apo më gjerë. Terminologjia e përdorur në raportin e vetëvlerësimit është e ndryshme dhe jo e qartë, gjë që jep indikacione se ka mungesë të transparencës mes rolit dhe përgjegjësisë në mes të mekanizmave të brendshëm dhe mungesë të të kuptuarit të karakteristikave të arsimit të lartë. Plan i strategjik është shumë i gjerë dhe tejet ambicioz, dhe nuk përkon me realitetin dhe me potencialet e institucionit.

Kapitulli i dytë (Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi / Pjesërisht e përmbushur), Ekspertët kanë konstatuar se Kolegji Iliria ka një strategji Institucionale që mbulon periudhën 2020-2025. Sipas ekipit të ekspertëve strategjia nuk është e balansuar mirë sa i përket komponentëve të ndryshëm dhe ajo nuk është e shoqëruar me një plan të veprimit. Institucioni duhet të qartësojë më shumë sistemin e vendimmarrjes dhe ta bëjë atë konsistent dhe të ketë rrjedhë logjike në nivele të ndryshme të organeve dhe procedurave vendimmarrëse. Megjithatë janë bërë disa përmirësime bazuar në rekomandimet e dala nga vlerësimi i fundit përkitazi me qeverisjen dhe vendimmarrjen, procedurat ende nuk janë të definuara mjaftueshëm dhe shumë pushtet është lënë në kompetencë të një personi, gjë që rezulton me mungesë të transparencës në proceset vendimmarrëse. Nuk ka kriteret e qarta se si merren vendimet si dhe nuk ka një proces të caktuar të ankimimit. Përveç kësaj, ekspertët kanë potencuar në raportin e vlerësimit se megjithatë ekziston një seksion për etikën, Kolegji nuk ka rregullore të mjaftueshme që i adresojnë procedurat e punësimit, konfliktin e interesit dhe/ose nepotizmin.

Kapitulli i tretë (Planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit / Pjesërisht e përmbushur), ekspertët e akreditimit kanë deklaruar në raportin e vlerësimit se nuk janë të bindur se burimet financiare të deklaruara janë të mjaftueshme për arritjen e objektivave të parapara në Strategjinë e institucionit për periudhën 2020-2025. Kolegji Iliria ka paraqitur një llogaritje të buxhetit vjetor dhe të atij trevjeçar, por nuk adreson çështjen e qëndrueshmërisë financiare. Ekspertët po ashtu kanë konstatuar se Kolegji pjesën më të madhe të burimeve financiare (65%) e ka nga pagesat e studentëve, gjë që dëshmon për një mungesë të stabilitetit financiar të institucionit.

Kapitulli i katërt (Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike / Pjesërisht e përmbushur), ekipi i ekspertëve të akreditimit ka evidentuar një varg dokumentesh të kolegjit Iliria që trajtojnë çështjet etike si dhe disa struktura të cilat kanë për detyrë garantimin e integritetit akademik. Megjithatë, ekspertët kanë konstatuar mungesë të rrjedhës së informatave në mes të komisioneve dhe organeve tjera organizative të institucionit me menaxhmentin. Përveç kësaj, ekspertët kanë vërejtur se rezultatet e zbatimit të kodit të etikës dhe informata tjera të kësaj natyre nuk janë të qasshme për publikun. Në kuadër të këtij kapitulli të standardeve, ekspertët e akreditimit kanë konstatuar mungesën e një programi kundër plagjiaturës.

Kapitulli i pestë (menaxhimi i cilësisë/ Pjesërisht e përmbushur), Ekspertët kanë konstatuar se kolegji Iliria në dhjetor 2019 ka miratuar rregulloren për sigurim të cilësisë, si përgjigje për mungesë të rregulloreve

në këtë fushë të identifikuar nga vlerësimi i viteve të kaluara. Zyra për Sigurimin e Cilësisë është themeluar vitin e kaluar dhe të gjithë punëtorët në këtë departament kanë qenë të punësuar më parë në Kolegj në pozita tjera. Ekipi i ekspertëve konsideron se ky veprim ka qenë më shumë një redistribuim i stafit administrativ të institucionit e jo punësim i bazuar në kompetencat e kërkuara për pozitën e caktuar. Sigurimi i cilësisë po ashtu është një nga fushat strategjike të përmendura në Planin Strategjik të Kolegjit 2020-2025 ku parashihet avancimi i disa procedurave. Në këtë kontekst ekspertët e akreditimit kanë potencuar se përveç faktit se sigurimi i cilësisë nuk nënkupton vetëm procedura, procedurat e paraqitura nuk mbulojnë tërë aktivitetin e institucionit, dhe hulumtimi dhe internacionalizimi nuk duket të jenë pjesë e proceseve të sigurimit të cilësisë. Raporti i brendshëm i vlerësimit i vitit 2018 i prezantuar nga Kolegji paraqet një interpretim të të dhënave të mbledhura nga pyetësorët, pa ndonjë analizë të tyre. Raportet e përgjithshme të vet-vlerësimit që ofrojnë pasqyrë të performancës së institucionit si tërësi duket se përgatitet vetëm për vlerësimin e jashtëm. Ekipi i ekspertëve nuk ka gjetur pyetësorë për stafin administrativ apo për punëdhënësit.

Kapitulli i gjashtë (Mësimdhënia dhe të nxëniet/ Pjesërisht e përmbushur), Ekspertët e akreditimit kanë konstatuar se sa i përket rregullimit të programeve të studimit, kolegji Iliria ka Statutin e Kolegjit dhe Strategjinë për Braktisje të Studimeve dhe Rregulloren e Ankesave të Studentëve. Ekipi i ekspertëve të akreditimit konsideron se ka ende shumë hapësirë për nevojë për të rregulluar procedura/dokumente akademike në rregullore të veçanta. Në vijim, ekspertët kanë konstatuar se institucioni nuk monitoron zbatimin e këtyre rregulloreve. Ekspertët nuk kanë gjetur evidencë të përfshirjes së të diplomuarve dhe punëdhënësve në ofrimin e komenteve dhe ideve për përmirësim të procesit të mësimdhënies dhe të nxëniet. Institucioni nuk ka pyetësorë të dizajnuar për këto kategori dhe si rezultat nuk ka një plan të përmirësimit të bazuar në perceptimet e akterëve të jashtëm.

Kapitulli i shtatë (Hulumtimi/ i pa përmbushur), Ekspertët e akreditimit kanë konstatuar se hulumtimi në kolegjin Iliria është prezantuar dhe elboruar në disa dokumente. Hulumtimi në kolegjin Iliria në njërin anë është tepër ambicioz sa i përket rolit, prezencës dhe vendit që zë në planifikimin institucional, por në anën tjetër është tejet modest, lokal dhe me produktivitet shumë të ulët. Plani i hulumtimi është shumë përshkrues dhe nuk ka tregues të performancës të përcaktuar qartë. Institucioni alokon fonde dhe përkrahë stafin mësimdhënës për angazhim në aktivitete kërkimore. Kryesisht këto fonde mbulojnë konferenca, udhëtime dhe pjesërisht publikime. Ekspertët rekomandojnë se buxheti për hulumtime duhet të artikulohet më mirë duke përshkruar ndarjen e fondeve sipas planit të hulumtimeve.

Produktiviteti kërkimor i stafit me orar të plotë është shumë i ulët, dhe raporti vjetor i publikimeve për person është shumë më i vogël se 1. Ekipi i ekspertëve ka pranuar një listë të projekteve e cila është shumë jo-transparente, ku renditen projekte që kanë përfunduar para disa viteve, shumë pakë që janë ende në proces, por pothuajse asnjë nuk mund të konsiderohet projekt hulumtues.

Plani për projekte hulumtuese është i paqartë, përshkrues dhe i pa aplikueshëm. E njëjta mund të thuhet për buxhetin e hulumtimeve i cili është jo transparent dhe i paqartë.


Kapitulli i nëntë (Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse/ Pjesërisht e përmbushur), ekspertët kanë konstatuar se megjithëse institucioni mbledhë të dhëna lidhur me nivelin e kënaqshmërisë së studentëve me programet, burimet mësimore dhe administratën e shërbimet mbështetëse, nuk ka evidencë të qartë se ato të dhëna përdoren për të mbështetur vendimmarrjen në nivel të kolegjit.

Ekspertët kanë konstatuar se Kolegji Iliria ka të themeluar zyrën e karrierës, mirëpo gjatë diskutimit me studentë u kuptua se ta nuk e kishin të qartë se çfarë aktivitete mbulon kjo zyrë. Kolegji Iliri ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi me punëdhënës të cilët ofrojnë mundësi të ndryshme për praktikë dhe punësim të studentëve dhe të të diplomuarve, por numri i atyre që përfitojnë nga këto marrëveshje nuk është mjaft përfaqësues. Në dokumentet e prezantuar nga institucioni dhe në diskutimet me studentë nuk është përmendur ndonjë organizim i aktiviteteve ekstrakurrikulare.

Kapitulli i njëmbëdhjetë (Bashkëpunimi institucional / Pjesërisht e përmbushur), ekspertët kanë konstatuar se Kolegji Iliria nuk ka ngarkuar një anëtar të menaxhmentit të lartë me portfolion për bashkëpunim institucional/internacionalizim. Përveç kësaj, angazhimi i stafit mësimdhënës në bashkëpunime ndërkombëtare kontributi në komunitet nuk janë të përfshira në vlerësimin e stafit dhe nuk monitorohen në vazhdimësi. Nuk ka një qasje të qartë në nivel të menaxhmentit për identifikimin e specifikave të institucionit në kudër të sistemit të arsimit të lartë në kontekstin lokal. Përveç kësaj, ekipi i ekspertëve konsideron jo funksionale përfshirjen e punëdhënësve lokal në komisionet këshillëdhënëse të kolegjit, dhe përfshirjen e Asociacionit të të diplomuarve.

Prandaj, duke u bazuar në gjetjet e ekspertëve si dhe në rekomandimin final të tyre për mos akreditimin e Kolegjit "Iliria", KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Specialistik të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Iliria
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.